



Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 612, datë 20.10.2021

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.212,
DATE 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, shifra "... 9 531 941 818 (nëntë miliardë e pesëqind e tridhjetë e një milionë e nëntëqind e dyzet e një mijë e tetëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH ..." zëvendësohet me "...10 459 484 196 (dhjetë miliardë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH ...".
2. Në nënndarjen "ii", të pikës 1, shifra "... 5 184 188 593 (pesë miliardë e njëqind e tetëdhjetë e katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë ..." zëvendësohet me "... 6 111 730 971 (gjashtë miliardë e njëqind e njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e një) lekë ...".

3. Në pikën 2.1 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shifra "... 3 928 793 173 (tre miliardë e nëntëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë ..." zëvendësohet me "... 4 539 106 464 (katër miliardë e pesëqind e tridhjetë e nëntë milionë e njëqind e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë ...".

b) Në fund të pikës 2.1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Efekti financiar shtesë për vitin 2021 do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë."

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 4834/1
DATË 21.10. 2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTRIT TË
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

